

U D H Ë Z I M
Nr. 4, datë 18.6.2002

**PËR DETYRAT E POLICISË SË SHTETIT NË FUSHATËN ZGJEDHORE PËR
ZGJEDHJET E PJESSHME NË ZONËN ZGJEDHORE NR.19 PËR DEPUTETË TË
DREJTPËRDREJTË PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 7.7.2002.**

Në mbështetje të nenit 18 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

Me qëllim garantimin e ecursë normale të procesit zgjedhor, organet e policisë së shtetit në raport me nivelet e ndryshme të komisioneve kanë këto detyra:

1. Shoqërimin me polic të mjeteve që do të transportojnë fletëvotimet nga magazina e KQZ-së deri në prefekturë dhe në KZZ-në nr.19, kundrejt kërkesës dhe planit të lëvizjes së mjeteve të miratuar nga KQZ-ja.

2. Organizimi i ruajtjes së ambienteve të punës së KZZ-së nr.19 gjatë periudhës zgjedhore, deri në dorëzimin në KQZ të tabelave të rezultateve dhe kutive të votimit nga KZZ-ja nr.19.

3. Organizimi i ruajtjes së qendrave të votimit të zonës zgjedhore nr.19 nga ora 12.00 e datës 6.7.2002 e në vijim, të vazhdojë deri në përfundimin e votimit, nxjerrjen e rezultateve dhe shoqërimin e përfaqësuesve të KQV-së për dorëzimin e tabelave të rezultateve dhe kutive të votimit në KZZ-në nr.19.

Për organizimin dhe realizimin e kësaj detyre KZZ-ja nr.19, i jep drejtorit të policisë në prefekturë një kopje të vendimit të KZZ-së nr.19 “Për caktimin vendndodhjes së qendrave të votimit” model 29.

4. Policët e caktuar me shërbim në qendrat e votimit, në mbrëmjen e datës 6.7.2002, të jenë prezent së bashku me anëtarët e KQV-së në momentin e mbylljes me çelës dhe dyllësjes së derës së qendrës së votimit. Në orën 7.00 të datës 7.7.2002, në prezencën të komisionit, asistojnë në hapjen e qendrës së votimit dhe nga ky moment deri në përfundimin e procesit, të ruajnë objektin në fjalë në distancë deri 100 m.

5. Nëse gjatë procesit të votimit rrezikohet rendi dhe zhvillimi i rregullt i votimit, kur cenohet rendi, kur shfaqen shenja dhune ndaj zgjedhësve apo anëtarëve të komisionit, kur pengohen procedurat e votimit dhe zgjidhja e konfliktit nuk mund të bëhet me mirëkuptim, KQV-ja vendos pezullimin e votimit dhe kryetari e zëvendëskryetari apo secili prej tyre kërkon ndihmën e policisë, duke njoftuar menjëherë edhe KZZ-në nr.19 për incidentin e ndodhur.

Me kërkesën e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KQV-së apo të secilit prej tyre, policët vihen në shërbim të Komisionit të Qendrës së Votimit, deri në evitimin e parregullsisë së vërejtur. Me rivendosjen e rendit, policëve u kërkohet të largohen nga qendra e votimit për të vazhduar ruajtjen në distancë të saj, ndërkohë KQV-ja merr masa për vazhdimin e procesit të votimit.

Me rivendosjen e rendit dhe rifillimin e votimit, KQV-ja informon KZZ-në nr.19.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.